Të shtëna me armë në Shkodër, plumbi depërton xhamin dhe përfundon në një banesë

20:09 - 14 Dhjetor, 2022

Të shtëna me armë janë regjistruar mbrëmjen e sotme në Shkodër. Sipas burimeve, një plumb ka thyer xhamin e një dritareje në një banesë në lagjen "Skanderbeg".

Nga hetimet e para dyshohet se në afërsi të zonës të njohur si Penda e lumit Kirit që ndodhet përballë me banesën në pronësi të Pal Sokolit, është shtënë me armë zjarri. Si pasojë plumbi ka goditur xhamin e dritares duke e thyer. Gazetari i Abc, Simon Shkreli raporton se në banesë ndodheshin banorët.

Nga të dhënat paraprake dyshohet të jetë plumb pistolete. Po kryhen hetimet nga ana e policisë e cila ndodhen në vendin e ngjarjes.

Njoftimi i policisë

"Më datë 14.12.2022, rreth orës 20:00, një shtetas ende i paidentifikuar, duke qarkulluar me automjet, në rrugën "Hilë Mosi", në lagjen "Skënderbeg", në ecje e sipër ka qëlluar një herë, me armë zjarri, në ajër. Si pasojë predha e plumbit ka rënë në dritaren e katit të tretë të banesës së shtetasit Pal Sokoli, 57 vjeç. Nga rënia e predhës nuk ka mbetur i dëmtuar asnjë person.

Grupi hetimor ka sekuestruar menjëherë pamjet e kamerave të rrugës, në të cilat dallohet drejtuesi i automjetit që ka qëlluar një herë me armë zjarri, në ajër. Vijojnë veprimet, nën drejtimin e Prokurorisë, për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit. Shërbimet e Policisë vijojnë kontrollin e zonës dhe janë ngritur pika kontrolli, në të gjitha rrugët, me qëllim bllokimin e automjetit dhe kapjen e autorit.", njofton policia.

/Abcnews.al/

*Kryesore | Aktualitet | Pal Sokoli | Shkodër | Te Shtena Me Arme

Të ngjashme

VIDEO/ Të shtëna me armë brenda hotelit në Afganistan, tre të vrarë

Normalizohet situata nga reshjet në vend, po punohet për të riparuar dëmet

Tragjedi në Itali, tre të vrarë në një kafene, mes tyre mikesha e kryeministres Meloni

Minute pas minute

11:50
A mund të furnizohet bota me energji nga shkrirja e atomeve?

11:45
Sulmi ndaj Berishës gjatë protestës, reagon për herë të parë Armi...

11:45
Didier Deschamps tronditi botën me përgjigjen për...

11:37
OKB: Sulmet ndaj infrastrukturës në Ukrainë do të...

11:35
NATO rrit buxhetin për sigurinë në Evropën Lindore

Shqipëria për Bashkimin Evropë
ARTIKULL JOETIK?

11:50 - 15 Dhjetor, 2022
A mund të furnizohet bota me energji nga shkrirja e atomeve?

11:45 - 15 Dhjetor, 2022
Sulmi ndaj Berishës gjatë protestës, reagon për herë të parë Armina Mevlani

11:45 - 15 Dhjetor, 2022
Didier Deschamps tronditi botën me përgjigjen për Benzema, mister para...

11:37 - 15 Dhjetor, 2022
OKB: Sulmet ndaj infrastrukturës në Ukrainë do të përkeqësojnë...

11:35 - 15 Dhjetor, 2022
NATO rrit buxhetin për sigurinë në Evropën Lindore

11:29 - 15 Dhjetor, 2022
Pse CIA u përpoq të vriste Bob Marley-n?

11:24 - 15 Dhjetor, 2022
Netflix sfidon William, transmeton intervistën e Dianës në BBC

11:16 - 15 Dhjetor, 2022
ZYRTARE/ UEFA fiton betejën kundër Superligës

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

| "Cash" | Privacy | Kushtet e Përdorimit |

Harta e faqes

Aktualitet | Botë | English
Politikë | Ekonomi | Life
Rajon | Emisione | Plus
Sport | Moti

Copyright © 2022 ABC NEWS. All rights reserved.